REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

# Kodi i lëndës: INF 274
# Lënda: Fizioterapi

| PROGRAMI I LËNDËS<br>**Fizioterapi** | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Titullari i lëndës:** | **Aferdita Nikaj** *Doktore Shkencash* ______________________________ | | | | | | | | | |
| **Ngarkesa:** | Kredite | Orë mësimi në auditor | | | | | | | Studim individual | Totali |
| | | Leksion | Seminar | Usht | Praktikë | Projekt | Total | | | |
| | 6 ECTS | 45 | 0 | 0 | 30 | 0 | 75 | | 75 | 150 |
| **Tipologjia e lëndës** | Lëndë ndërdisiplinore / integruese | | | | | | | | | |
| **Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda** | Viti II, Semestri I | | | | | | | | | |
| **Lloji i lëndës** | Me zgjedhje | | | | | | | | | |
| **Programi i studimit** | Bachelor në Infermieri Mami | | | | | | | | | |
| **Kodi i lëndës** | INF 274 | | | | | | | | | |
| **Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës** | aferdita.nikaj@univlora.edu.al | | | | | | | | | |

| **PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT** | |
|---|---|
| **Përshkrimi i lëndës** | Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri profesionale mbi modalitetet e ndryshme bazë që përdoren në fizioterapinë bashkëkohore si dhe aplikimin e fizioterapisë në disa patologji specifike sipas fushave të ndryshme të mjekësisë në të cilat kjo shkencë gjen zbatim. |
| **Objektivat e lëndës** | ▪ Njohja me konceptet bazë të fizioterapisë së përgjithshme<br>▪ Zbatimi i gjerë i saj në fusha të ndryshme të mjekësisë speciale me qëllim promovimin shëndetësor, parandalimin e sëmundshmërisë si dhe diagnostikimin, aftësimin, trajtimin dhe rehabilitimin integral të pacientit me patologji të ndryshme të lindura apo të fituara gjatë jetës, me qëllim riaftësimin dhe rifitimin e funksioneve fiziologjike të organizmit për realizimin e aktiviteteve të jetës së përditëshme dhe rritjen e cilësisë së jetës.<br>▪ Njohja me procedurat dhe modalitetet e aplikimit të agjentëve fizikë në ditët e sotme,<br>▪ Njohja me efektet biologjike, indikacionet dhe kunderindikacionet e modaliteteve fizioterapeutike<br>▪ Njohja me aplikimi e fizioterapisë në patologji të caktuara të fushave të ndryshme mjekësore si: kirurgjia, traumatologjia, ortopedia, reumatologjia, neurologjia, pediatria, geriartria, kardiologjia, pneumologjia, dermatologjia, gjinekologjia, mjekësia sportive etj, në të cilat gjen zbatim fizioterapia. |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme** | Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:<br>☞ Të njohin parimet e praktikës fizioterapeutike.<br>☞ Të diferencojnë benefitet e modaliteteve të ndryshme fizioterapeutike në patologji të veçanta.<br>☞ Të realizojnë procedurat të ndryshme fizioterapeutike në bazë të mendimit kritik.<br>☞ Të veprojnë duke respektuar indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të modaliteteve fizioterapeutike. |

## KONCEPTET THEMELORE

1. Parimet bazë në fizioterapi.
2. Anatomia dhe fiziologjia e trupit të njeriut.
3. Procedurat diagnostikuese të sistemit neuro-muskulo-skeletik..
4. Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i sëmundshmërisë nëpërmjet përdorimit të agjentëve fizikë.
5. Teknikat themelore fizioterapeutike parandaluese dhe rehabilituese.
6. Përkujdesjet shëndetësore gjatë gjithë jetës..

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| I. | **Tema 1** – Koncepte bazë në fizioterapi.<br>*Njohja me konceptet bazë në fizioterapi.*<br>**Tema 2** - Fizioterapia dhe trupi ynë.<br>*Njohja me ndërtimin e trupit të njeriut.*<br>**Tema 3** - Fushat e aplikimit të fizioterapisë.<br>*Njohja me fushat e aplikimit të fizioterapisë.*<br><br>**Praktikë mësimore** në kabinetin e fizioterapisë. | *fq 1-9*<br><br>*fq10-12*<br><br>*fq 13-17* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| II. | **Tema 4** - Metodat diagnostike të sistemit neuro-muskulo- skeletik dhe njohja me disa patologji të ndjeshme ndaj rehabilitimit.<br>*Njohja me metodat diagnostike, imazherike, skanerat nukleare, diagnostikime të tjera, si dhe disa patologji të ndjeshme ndaj rehabilitimit.*<br>**Tema 5** - Agjentët fizikë natyralë. Helioterapia.<br>*Njohja me rëndësinë, indikacionet dhe kundërindikacionet e banjove të diellit.*<br>**Tema 6** - Agjentët fizikë natyralë. Klimatoterapia.<br>*Njohja me agjentët fizikë, rëndësinë dhe efektet e klimës bregdetare dhe malore.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e diagnostikës. | *fq 18-30*<br><br><br><br><br>*fq 35-38*<br><br><br>*fq 31-34* | Leksion 1 orë<br><br><br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| III. | **Tema 7** - Agjentëtfizikënatyralë. Talasoterapia.<br>*Njohja me rëndësinë, indikacionet dhe kundërindikacionet e banjove të detit.*<br>**Tema 8** - Hidrologjiadhe hidroterapia.<br>*Njohja me efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e hidroterapisë.*<br>**Tema 9** - Format e aplikimit të hidroterapisë. Banjot dhe dushet.<br>*Njohja me format e aplikimit të hidroterapisë si banjo dhe dushe.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e kirurgjisë. | *fq 39-42*<br><br><br>*fq 43-46*<br><br>*fq 47-51* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>*Praktikë 2 orë* |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| IV. | **Tema 10** - Agjentët fizikë. Termoterapia.<br>*Njohja me format e aplikimit, efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të procedurave të ngrohta.*<br>**Tema 11 -** Agjentët fizikë. Krioterapia.<br>*Njohja me format e aplikimit, efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të procedurave të ftohta.*<br>**Tema 12 -** Elektrologjia dhe elektroterapia. Elektroterapia antalgjike dhe e stimulimit.<br>*Njohja me fushat e aplikimit, modalitetet e përdorimit si dhe llojet e elektroterapisë.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e patologjisë | *fq 52-56*<br><br><br>*fq 59-61*<br><br><br>*fq 62-66.* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| V. | **Tema 13 -** TENS dhe jonoforeza.<br>*Njohja me format e aplikimit, efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të TENS-it dhe jonoforezës.*<br>**Tema 14** – Ultrasonoterapia.<br>*Njohja me format e aplikimit, efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të ultratingujve.*<br>**Tema 15** – Magnetoterapia.<br>*Njohja me efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të elektromagnetoterapisë.*<br><br>**Praktikë mësimore** në kabinetin e fizioterapisë. | *fq 67-70*<br><br><br>*fq 71-76*<br><br><br>*fq 77-79* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| VI. | **Tema 16 -** Fototerapia. Terapia me rreze infra tëkuqe.<br>*Njohja me efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të rrezatimit infra të kuq.*<br>**Tema 17 -** Fototerapia. Terapia me rreze ultravioletë.<br>*Njohja me efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të rrezatimit ultravioletë.*<br>**Tema 18** - Fototerapia. Laserterapia.<br>*Njohja me format e aplikimit, efektet, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të laserit.*<br><br>**Praktikë mësimore** në në shërbimin e neonatologjisë. | *fq 85-88*<br><br><br>*fq 89-92*<br><br><br>*fq 80-84* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| VII. | **Tema 19 -** Masoterapia. Masoterapia refleksogjene.<br>*Njohja me karakteristikat, llojet, tipet, teknikat bazë, indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të masazhit.*<br>**Tema 20 –** Limfo drenazhi dhe presoterapia.<br>*Njohja me aplikimin, indikacionet dhe kundërindikacionet e limfodrenazhit dhe presoterapisë.*<br>**Tema 21 –** Tecarterapia.<br>*Njohja me efektet, modalitetet e përdorimit, indikacionet dhe kundërindikacionet e TECAR-it.*<br><br>**Praktikë mësimore** në pavionin e patologjisë. | *fq 93-108.*<br><br><br>*fq109-115*<br><br>*fq116-120* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| VIII. | **Tema 22** – Bandazhet.<br>*Njohja me tipet e bendeve dhe aplikimete bandazhit.*<br>**Tema 23 -** Kineziologjia dhe artrologjia. | *fq 144-145*<br><br>*fq 121-130* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| | *Njohja me kineziologjinë, pozicionin anatomik, posturën, planet dhe akset referente, artrologjinë e artikulacioneve të ekstremiteteve të sipërme, të poshtëme dhe të segmenteve përbërëse të shtyllës kurrizore.*<br>**Tema 24 -** Kineziterapia dhe rehabilitimi. Ushtrimet terapeutike aktive dhe pasive.<br>*Njohja me klasifikimin e ushtrimeve, kineziterapinë aktive dhe pasive.*<br><br>**Praktikë mësimore** në pavionin e patologjisë. | *fq 136-143* | Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **IX.** | **Tema 25 -** Mjekësia tradicionale kineze.<br>*Njohja me parimet e mjekësisë tradicionale kineze, akupunturën, instrumentet, teknikën, indikacionet, kundërindikacionet dhe rreziqet e saj.*<br>**Tema 26 -** Aerobia dhe anaerobia.<br>*Njohja me ushtrimet aerobike dhe anaerobike si dhe benefitet e tyra shëndetësore.*<br>**Tema 27 -** Fizioterapia ne shtatëzani.<br>*Njohja me ndryshimet fiziologjike, sportet dhe ushtrimet, pasojat e stërvitjes dhe kundërindikacionet e stërvitjes gjatë shtatëzanisë.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e obstetrikës. | *fq 146-149*<br><br>*fq 150-153*<br><br>*fq 154-164* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **X.** | **Tema 28 -** Fizioterapia respiratore. Drenazhi postural.<br>*Njohja me objektivat dhe teknikat e rehabilitimit respirator.*<br>**Tema 29 -** Fizioterapia respiratore pediatrike në bronkitis, bronkiolitis, alveolitis, pneumoni.<br>*Njohja me teknikat e rehabilitimit respirator në sëmundjet pulmonare.*<br>**Tema 30 -** Fizioterapia kardiovaskulare. Fizioterapia në IAM.<br>*Njohja me objektivat dhe teknikat e rehabilitimit kardiovaskular.*<br><br>**Praktikë mësimore** në në shërbimin e pediatrisë dhe të kardiologjisë. | *fq 165-174*<br><br>*fq175-176*<br><br>*fq 177-182* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **XI.** | **Tema 31 -** Fizioterapianëpediatri. Fizioterapianëfemijët me paralizëcentrale.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në patologji të ndryshme që prekin moshat pediatrike, si dhe në PCI.*<br>**Tema 32 –** Fizioterapia në pediatri. Fizioterapia në fëmijët me poliomielit.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në fëmijët me poliomielit.*<br>**Tema 33 -** Fizioterapia në neurologji. Fizioterapia në pacientin hemiplegjik.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në neurologji dhe hemiplegji.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e pediatrisë. | *fq 183-189*<br><br>*fq 190-192*<br><br>*fq 195-197* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **XII.** | **Tema 34 –** Fizioterapia në neurologji. Fizioterapia në pacientin me paraplegji inferiore.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në pacientin me paraplegji inferiore.*<br>**Tema 35 –** Fizioterapia në neurologji. Fizioterapia në pacientin me aksident cerebro- vaskular. | *fq 198-200*<br><br>*fq 201* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| | *Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në AVC.*<br>**Tema 36 -** Fizioterapia në ortopedi. Fizioterapia në sindromin e dhimbjeve te mesit.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në ortopedi dhe sindromin e dhimbjes së mesit.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e neurologjisë dhe ortopedisë. | *fq202-206* | Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **XIII.** | **Tema 37 –** Fizioterapia në ortopedi. Orteza dhe proteza. Fizioterapia në pacientin me protezë coxo-femorale.<br>*Njohja me ortezat dhe protezat si dhe masat fizioterapeutike në pacientin me protezë coxo-femorale.*<br>**Tema 38 –** Fizioterapia në ortopedi. Artroplastika totale e gjurit.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike në pacientin me artroplastikë totale të gjurit.*<br>**Tema 39 –** Fizioterapia në traumatologji. Fizioterapia në kontraktura dhe kontuzionet muskulare.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në traumatologji, si dhe në lezionet muskulo-artikulare.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e ortopedisë dhe traumatologjisë. | *fq 207-208.*<br><br>*fq 209.*<br><br>*fq 211-215* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **XIV.** | **Tema 40 –** Fizioterapia në traumatologji. Fizioterapia në hernien diskale.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në hernien diskale.*<br>**Tema 41 –** Fizioterapia në reumatologji. Fizioterapia në artrite.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në reumatologji, si dhe në artrite.*<br>**Tema 42 -** Fizioterapia në reumatologji. Fizioterapia në artroza.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në artroza.*<br><br>**Praktikë mësimore** në shërbimin e traumatologjisë dhe reumatologjisë. | *fq 216-217*<br><br>*fq 218-22.*<br><br>*fq 223-225* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **XV.** | **Tema 43 –** Fizioterapia në reumatologji. Fizioterapia në osteoporozë.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në osteoporozë.*<br>**Tema 44 –** Fizioterapia në geriartri. Fizioterapia në parkinson.<br>*Njohja me masat fizioterapeutike që përdoren në geriartri dhe parkinson.*<br>**Tema 45 –** Fizioterapia në kirurgji. Fizioterapia pre dhe postoperatore.<br>*Njohja me fizioterapinë pre dhe postoperatore.*<br><br>**Praktikë mësimore** në pavionin e kirurgjisë. | *fq 226*<br><br>*fq227-230*<br><br>*fq 231-234* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |

| FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE | |
|---|---|
| **FREKUENTIMI:** | Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohet një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).<br>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura. | | | | | |
| **KONTROLLI I VAZHDUESHËM** | *Forma e vlerësimit* | *Koha e vlerësimit* | *Temat mësimore që do vlerësohen* | *Pikët maksimale* | *Forma e testimit të njohurive* | *Përmbajtja e testimit* |
| | Provimi I | Java 7/8 | 15 leksione | 30 pikë | Provim me shkrim | Pyetje me shtjellim, pyetje quiz, situata për menaxhim |
| | Provimi përfundimtar | Fundi i semestrit | 30 leksione | 60 pikë | Provim me shkrim | Pyetje me shtjellim, pyetje quiz, situata për menaxhim |
| | Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*) | Java 14/15 | Raste klinike | 10 pikë | Prezantim me gojë | Përshkrimi i rasteve klinike të hasura gjatë praktikës në repartin e Urgjencës Mjekësore |
| | **Vlerësim i vazhduar* - Do të realizohet prej pedagogut të praktikës për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të diskutojnë në mënyrë periodike rastet apo procedurat praktike më të shpeshta fizioterapeutike, që kanë hasur në praktikë.<br><br>**Detyra e kursit* - Do të jetë në formën e një projekti që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë studime rastesh apo procedurat praktike më të shpeshta fizioterapeutike, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike. Një pjesë e punimeve do të prezantohen dhe në PPT. | | | | | |
| | Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë: | | | | | |
| | 40- 49 pikë | 50-59 pikë | 60-69 pikë | 70-79 pikë | 80-89 pikë | 90-100 pikë |
| | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |

| **LITERATURA** | |
|---|---|
| **Literatura bazë e detyruar** | 1. **'Fizioterapia'** Cikël leksionesh – B. Subashi, 2016 (FSHP-UV)<br>2. '**Metodat dhe teknikat themelore të trajtimit në fizioterapi'**, Dr. Valbona Hibraj, Brunilda Subashi |
| **Literatura e rekomanduar** | o Albornoz Cabello, Manuel; Meroño Gallut, Antonio Javier (2012-07-20). Procedimientos generales de fisioterapia (Spanish Edition) (Kindle Locations 358-362). Kindle Edition. ISBN: 978-84-8086-821-1<br>o Módulo I : Generalidades, ISBN: 9788466538312<br>o Módulo II : Neurología, Pediatría y Fisioterapia respiratoria, ISBN: 9788466538381<br>o Módulo III : Traumatología, Afecciones Cardiovasculares y Otros Campos de Actuación, ISBN 978-84-665-3834-3<br>o 'Agentes Fisicos Terapeuticos', Dr. Jorge E. Martin Cordero, e disponueshme ne http://www.slideshare.net/mtobarb/agentes-fisicosterapeuticoslahabana<br>o 'Fizioterapia', cikël leksionesh, V. Prifti 2011-2012.<br>o 'Agentes Fisicos Terapeuticos', Dr. Jorge E. Martin Cordero, e disponueshme ne http://www.slideshare.net/mtobarb/agentes-fisicosterapeuticoslahabana |

| | |
|---|---|
| | ○ 'Tidy's physiotherapy' 2005, Butterworth-Heineman<br>○ 'Physiotherapy in Orthopaedics, A problem Solving Aproach' 2005 Karen Atkinson, Fiona Coutts et al. 2nd edition<br>○ 'The Physiotherapy Site', http://www.thephysiotherapysite.co.uk/<br>○ 'Terapia-Fisica.com', http://www.terapia fisica.com<br>○ Fisioterapia.net, http://www.efisioterapia.net |

| VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS | |
|---|---|
| **Dispozita:** | Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar. |
| **Vonesat** | Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student. |
| **Sjellja profesionale e studentit** | Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit. |
| **Integriteti akademik dhe e drejta e autorit** | Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale.<br>Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme. |